

PËRMbledhje JOTEKNIKE PËR AKTIVITETIN



SUBJEKTI: "ALBAMACHINERY"

Klasifikimi i projektit: Në bazë të Ligjit nr.52/2020 të datës 30.04.2020 për disa ndryshime të ligjit nr.10440 datë 07.07.2011 "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis", ky aktivitet përfshihet në Shtojca 1, Industrinë prodhuese të makinerive dhe pajisjeve pika ID.10.1 "Prodhim i makinerive dhe pajisjeve nëqoftëse nuk janë përmendur diku tjetër në shtojcë"

ADMINISTRATORI I SUBJEKTIT: Mariano Menagarelli

VENDODHJA: Durrës, Komuna Xhafzotaj, Autostrada Durrës-Tiranë kilometri i pestë.

Hyrje

Mjedisi është burim i gjithckaje për të cilën njerëzit kanë nevojë për të jetuar dhe për tu zhvilluar. Sa më i degraduar të jetë mjedisi aq më keq ndikon në shëndetin e njeriut dhe zhvillimin ekonomiko-social, prandaj duhet nje menaxhim sa më i mirë i tij. Vendi ynë është anëtar i një numri konventash ndërkombëtare, si rrjedhojë është i detyruar të zbatojë një sistem sa më efektiv në fushat ekonomike-sociale-mjedisore, për rregullimin e territorit sidomos në funksion të zgjedhjes së problemeve të ndryshme mjedisore.

Ky raport do të paraqesë rëndësinë e zbatimit të projektit **Industritë prodhuese të makinerive dhe pajisjeve pika ID.10.1 “Prodhim i makinerive dhe pajisjeve nëqoftëse nuk janë përmendur diku tjetër në shtojcë”**, përshkrimin e këtij projekti dhe nga ana tjetër ndikimet kryesore negative në mjedis, masat zbutëse për të minimizuar sa më shumë të jetë e mundur këto ndikime negative, duke llogaritur se si qëndron ekuilibri ndërmjet tyre për të arritur një zhvillim të qëndrueshëm. Zhvillimi i qëndrueshëm mund të përkufizohet si zhvillim që plotëson nevojat e së tashmes pa cenuar mundësitë e brezave të ardhshëm për të përmbushur nevojat e tyre.

Në raport do të paraqitet realizimi i këtij projekti dhe zhvillimi ekonomik që përfitohet prej zbatimit të tij por gjithmonë duke mbrojtur mjedisin, duke patur parasysh parimin e “zhvillimit të qëndrueshëm”. Ky dokument prezanton gjithashtu dhe palët që marrin pjesë, përfitojnë apo preken nga zbatimi i tij.

Shoqëria “Albamachinery” sh.p.k është themeluar në vitin 2012 me administrator Z.Mariano Managarelli. Albamachinery është një kompani e re në industrinë e prodhimit të pajisjeve apo makinerive të ndryshme që operon në Shqipëri. Ajo është përfshirë në aktivitetet e montimit mekanik dhe elektrik të makinerive të ndryshme. Përvoja industrial e lejon të zgjidhë cdo nevojë në këtë sektor. Departamenti Teknik ndërvepron me klientët për të optimizuar të gjitha aspektet e ndërtimit të strukturave metalike deri tek montimi i plotë i makinerive të përfundura dhe të testuara.



<https://geoportal.asig.gov.al> ofron të dhëna gjeohapësinore të ofruara nga autoritetet publike përgjegjëse. Përgjegjësia për saktësinë e të dhënave është e autoritetit publik që i ka krijuar ato.



Sistemi koordinativ: KRGJSH
Projektimi: KRGJSH

1. Përshkrimi i subjektit

Operatori “ALBAMACHINERY” i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me NIPT: L22118502S dhe formë ligjore SHPK, operon prej 10 vitesh në tregun vendas. Albamachinery u themelua në vitin 2012 nga një menaxhim italian i cili ende ndjek zhvillimin teknik, organizativ dhe tregtar të kompanisë. Bashkëpunimet e ngushta me kompani ndërkombëtare në

projektimin dhe ndërtimin e impianteve industriale lejojnë rritjen e vazhdueshme të aftësive të kompanisë.

Qëllimi i Shoqërisë është prodhimi i makinerive dhe pajisjeve nëpërmjet përdorimit të llamarinave, bulonave apo mjeteve të tjera ndihmëse, të cilat do të përdoren më pas për realizimin e shiritave në xhamat e makinave të llojeve të ndryshme. Departamenti Teknik ndërvepron me klientët për të optimizuar të gjitha aspektet nga ndërveprimi i strukturave metalike deri tek montimi i plotë i makinerive të përfundurara dhe të testuara. Këto pajisje eksporthohen në Itali, Meksikë dhe Kubë.

2. Vendodhja e aktivitetit

Aktiviteti ushtrohet në Durrës, Komuna Xhafzotaj, Autostrada Durrës-Tiranë kilometri i pestë. Zyra teknike ndërvepron me zyrën teknike të klientit në mënyrë që të zgjedh të gjitha aspektet: nga ndërtimi i strukturave strukturore metalike deri në montimin e plotë të makinave të përfunduara dhe të testuara. Kompania operon në një sektor industrial të vendosur në Durrës me një strukturë prej 500 m2 zyra dhe 4500 m2 zona e prodhimit. Në kompani mund të gjenden në dispozicion zyrat e mëposhtëme:

- Zyra teknike me stacione pune 3D
- Departamenti i blerjeve
- Administrata

Ndërsa prodhimi realizohet nga departamentet e mëposhtëme:

- Asambleja mekeanike
- Montimi i bordit të makinës elektrike
- Montimi i paneleve elektrike
- Logjistika

Zona e përzgjedhur për ushtrimin e këtij aktiviteti është e përshtatshme për këtë lloj aktiviteti duke pasur parasysh përparësitë si:

- Furnizimi me ujë
- Furnizimi me energji elektrike
- Lehtësi në aksesim nga automjetet (automjetet për ngarkim shkarkim, zjarrfikset dhe ambulancat)

Më poshtë po japim koordinatat e vendodhjes së sheshit të propozuar për zhvillim sipas sistemit Gaus Kruger.

Pikat	X	Y
1	458753.533	4578852.363
2	458790.403	4578786.283
3	458870.573	4578832.483
4	458834.173	4578897.443

3. Aktiviteti dhe instalimet e tij

Operatori do të ushtrojë aktivitetin “Prodhim i makinerive dhe pajisjeve” nëpërmjet përdorimit të llamarinave, bulonave apo materialeve të tjera ndihmëse. Të gjitha makineritë që disponon ky subjekt janë bashkëkohore dhe janë të importuara më së shumti nga bashkimi evropian. Si energji për funksionimin e tyre kanë rrymën elektrike.

Lënda e parë llamarinë me forma dhe dimensione të ndryshme pasi magazinohet në ambiente të mbyllura për të shmangur korredimin, transportohet nëpërmjet pirunit dhe kalon në procesin e parapregatitjes së produktit.

Procesi i prerjes dhe përpunimit të llamarinave realizohet nëpërmjet operacionit të tranxhimit të tyre në trajtë shiritash. Prerja realizohet nëpërmjet thikave sipas parimit të gërsërës. Makina është hidraulike dhe me kontroll numerik.

Lazeri bën të mundur prerjen dhe dhënien e formës së profileve metalike. Profilet metalike kanë forma dhe dimensione të ndryshme dhe përdorimi i pikatrics bën të mundur kthimin dhe dhënien e formës së metalit.

Metali më pas kalon në procesin e lyerjes me kompresor. Fillimisht realizohet procesi i pastrimit të sipërfaqeve me rërë abrasive 0.5-1.2 mm në mënyrë manuale dhe sipas standartit. Bëhet pastrimi me ajër i sipërfaqjes si dhe kontrolli i parametrave të punës, së temperaturës, lagështisë relative si dhe pregatitja e bojës nga dy komponentë së bashku. Lyerja realizohet në disa faza. Fillimisht realizohet lyerja me bojë antikorrozive si brenda dhe jashtë. Trashësia e krijuar arrin deri në 35 mikron. Më tej bëhet lyerja e dytë me bojë antikorroziveku ku trashësia e krijuar arrin në 60-70 mikron.

Gjithashtu kemi të pranishme dhe tavolinat e punës ku bëhet puna manualisht nga punëtorët e subjektit.



Pjese te asambuara te bazes se makinerive qe do te krijohen (furra per stampimin e xhamave)



Furra ne foto eshte nje nga makinerite e krijuara si product perfundimtar I subjektit



Rregullat e MNZ dhe shendetit ne pune zbatohen me perkriptmeri pasi subjekti ka dhe certifikimin ISO 45001

4. Burimet e shkarkimeve nga instalimi

4.1 Shkarkimet në ajër

Nga aktiviteti në mjedisin e jashtëm nuk do të ketë emetime të gazrave, të cilat und të ndikojnë negativisht në shëndetin e punonjëve apo banorëve të mjedisit për rreth.

4.2 Shkarkimet në ujëra

Nga aktiviteti nuk do të ketë shkarkime të ujërave teknologjike dhe të substancave të tjera të dëmshme të cilat mund të ndikojnë negativisht në shëndetin e punonjësve, banorëve dhe mjedisit për rreth. Ujërat e zeza që do të krijohen nga ujërat për përdorim sanitar derdhen në një gropë septike e cila ka kontratë me një operator.

4.3 Gjenerimi i zhurmave

Nga aktiviteti në mjedisin e brendshëm krijohen zhurma nga pajisjet dhe makineritë që punojnë, por ndikimi i tyre në mjedisin e jashtëm është i papërfillshëm.

4.4 Gjenerimi i mbetjeve

Mbetjet që prodhohen nga ky aktivitet janë kryesisht letra dhe kartona të cilat janë të riciklueshme dhe terhiqen nga shoqëria e kontraktuar "ECO EMPIRE". Ndërsa mbetjet urbane që dalin si rezultat i aktivitetit të punonjësve do të grumbullohen në vendet e caktuara nga Pushteti Vendor. Kompania do të punojë për ndarjen e tyre që në burim, nëpërmjet vendosjes së kontenerëve me ngjyra.

5. Natyra dhe sasi të shkarkimeve të pritshme nga instalimi në cdo vend/mjedis, si dhe identifikimi i efekteve të rëndësishme të shkarkimeve në mjedis

Shkarkimet që vijnë si pasojë e zhvillimit të aktivitetit nuk mund të konsiderohen ndotëse. Këto shkarkime do të jenë normale, Brenda normave të legjislacionit aktual në fuqi. Operatori do të marrë masa të vazhdueshme për minimizim sa më të madh të tyre, duke kryer edhe monitorimet periodike sipas kushteve që do të vihen në leje.

NDIKIME NEGATIVE NË MJEDIS
<i>Rrezatimi Jonizues</i>
Nga zhvillimi i aktivitetit nuk do të kemi rrezatime jonizuese.
<i>Vibracionet</i>
Funksionimi i aktivitetit nuk gjeneron vibrime
<i>Ndikimet në popullsi</i>
Realizimi i projektit nuk do të ketë ndikime në lëvizjen apo zhvendosjen e popullsisë së rajonit ku do të zbatohet projekti.
<i>Ndikimet në tokë</i>
Nuk do të ketë ndikime të konsiderueshme në tokë. Të vetmet ndikime negative që mund të shkarkohen do të jenë si pasojë e shkarkimit të vajrave dhe lubrifikantëve nga mjetet e punës për shkak të ndonjë avarie teknike.
<i>Mbetjet e ngurta</i>
Mbetjet e ngurta që dalin si rezultat i aktivitetit të punonjësve do të grumbullohen në vendet e caktuara nga shoqëria dhe më pas do të dergohen për në vendet e caktuara nga pushteti vendor. Kompania do të punojë për ndarjen e tyre që në burim. Ndërsa mbetjet që gjenerohen nga procesi i punës si lera apo kartona do të tërhiqen nga kompania e kontraktuar ECO EMPIRE.
<i>Ndikimet në ajër</i>
Referuar natyrës së aktivitetit mund të kemi ndikime negative në ajër nga përdorimi i mjeteve motorrike që frekuentojnë ambientet e shoqërisë. Megjithatë në pikëpamjen mjedisore dhe shëndetësore këto ndikime janë të papërfillshme.
<i>Ndikimet në ujëra</i>

Funksionimi i aktivitetit nuk do të ketë ndikime në ujëra. Ujërat e zeza që shkaktohen si pasojë e ujërave për përdorim sanitar derdhen në një gropë septike që ka kontratë me një operator
<i>Ndikimimet në klimë</i>
Gjatë zhvillimit të aktivitetit nuk priten ndryshime të dukshme klimaterike, si në drejtim të përmirësimit apo përkeqësimit të saj. Nuk do të ketë ndryshime në temperaturë, në drejtim të erës, në sasinë e rreshjeve. Pra kryerja e aktivitetit nuk ndikon aspak në kushtet klimaterike të kësaj zone.
<i>Ndikimet në florën dhe faunën</i>
Zona në të cilën ushtrohet aktiviteti është një zonë e cila nuk ka ndikime në florë dhe faunë. Operatori do të shtojë sipërfaqjet e gjelbërta për një pamje vizuale më të kënaqshme për syrin dhe për të mirat në pikëpamjen mjedisore.
<i>Ndikimet nga zhurmat</i>
Nga aktiviteti në mjedisin e brendshëm krijohen zhurma nga pajisjet dhe makineritë që punojnë, por ndikimi i tyre në mjedisin e jashtëm është i papërfillshëm.
<i>Ndikimet e aktivitetit të zhvillimit mbi ndërtimet, trashëiminë arkitektonike historike dhe zonat e mbrojtura</i>
Aktiviteti që ushtron shoqëria zbatohet në një zonë në sipërfaqjen e së cilës dhe në nëntokën e saj nuk ka ndërtime lidhur me trashëgiminë arkitektonike dhe historike, tiparet arkeologjike, si dhe mbi vepra njerëzore. Kjo tregon se zona është zonë e lirë jo vetëm për të realizuar këtë aktivitet por dhe aktivitete të tjera.
<i>Ndikimi social-ekonomik</i>
Me operimin e këtij aktiviteti pritet të ketë një impakt pozitiv në ekonominë e vendit në aspektin e punësimeve

6. Të dhënat për përdorimin e lëndëve të para gjatë funksionimit përfshirë sasinë e ujit të nevojshëm të energjisë.

Gjatë funksionimit të projektit do të nevojitet uji, energjia elektrike si dhe produkte të konsumit të përditshëm.

Uji që nevojitet për zbatimin e këtij projekti është marrë nga rrjeti kryesor nëpërmjet një matësi në pikën më të afërt të mundshme, e cila është caktuar nga Ndërmarrja e Ujësjellësit që e ka në përdorim linjën e Ujësjellës Kanalizime Durrës. Lidhjet me rrjetin kryesor dhe kostot përkatëse në lidhje me furnizimin me ujë do të paguhet nga Shoqëria.

Furnizimi me energji elektrike

Energjia Elektrike që nevojitet do të merret nga Rrjeti kryesor elektrik nëpërmjet një matësi në pikën më të afërt të mundshme, e cila do të caktohet nga filiali i OSHEE që e ka në përdorim linjën elektrike dhe do të jepet në përdorim më anë të kontratës përkatëse.

7. Natyra dhe sasinë e shkarkimeve të pritshme nga instalimi në cdo vend/mjedis, si dhe identifikimi i efekteve të rëndësishme të shkarkimeve në mjedis

Shkarkimet që vijnë si pasojë e zhvillimit të aktivitetit nuk mund të konsiderohen ndotëse. Këto shkarkime do të jenë normale, brenda normave të legjislacionit aktual ne fuqi. Operatori do të marrë masa të vazhdueshme për minimizim sa më të madh të tyre, duke kryer monitorimet periodike sipas kushteve që do ti vihen në leje. Çlirime të lehta në ajër do të konsiderojmë gazet e mjeteve që frekuentojnë ambientet e këtij aktiviteti.

Nr.	Receptori Mjedisor	Operacioni dhe pasoja në mjedis
1	Cilësia e ajrit	Emetime gazesh nga automjetet dhe pluhuri për shkak të qarkullimit të tyre
2	Zhurma	Gjatë procesit të punës krijohet njeфарë zhurme që është e përkohshme
3	Cilësia e ujërave	Nuk ka shkarkime të rëndësishme në ujëra.
4	Toka	Rrjedhjet aksidentale nga automjetet
5	Mbetjet	Aktiviteti njerëzor i punonjësve si dhe nga aktiviteti i prodhimit të pajisjeve dhe makinerive.

8. Teknologjia dhe teknika të propozuara për parandalimin e shkarkimeve

Teknikat më të mira të disponueshme (TMD) do të thotë faza më efektive dhe e avancuar në zhvillimin e aktiviteteve dhe metodat e tyre të veprimit të cilat tregojnë përshtatshmërinë praktike të teknikave dhe metodat e tyre të veprimit të cilat tregojnë përshtatshmërinë praktike të teknikave të veçanta për të siguruar në parim bazat për vlerat limite të emetimeve.

Teknika përfshin të dyja si teknologjinë e përdorur dhe mënyrën në të cilën impianti është projektuar, ndërtuar, mirëmbajtur, operuar dhe çmontuar. Teknikat më të mira të disponueshme do të thotë ato janë të zhvilluara në një shkallë që lejon zbatimin në sektorin përkatës industrial, nën kushte ekonomikisht dhe teknikisht të zbatueshme, duke marrë parasysh kostot dhe përparësitë, nëse janë apo nuk janë përdorur ose prodhuar teknikat brenda territorit të palës në fjalë, për aq kohë sa ato janë mjaft të lejueshme për operatorin. Në përcaktimin e teknikave më të mira të disponueshme, konsideratë të veçantë duhet t'i jepet, në përgjithësi ose në raste të veçanta faktorëve të mëposhtëm, duke pasur parasysh kostot më të mundshme dhe përfitimet nga një masë dhe parimet e masës paraprake dhe parandalimit.

Proçeset e krahasueshme, pajisjet apo metodat e funksionimit të cilat kanë qënë provuar me sukses në një shkallë industriale

1. Përparimet teknologjike dhe ndryshimet në njohuri shkencore dhe të kuptuarit;

2. Natyra, efektet dhe vëllimi i emetimeve në fjalë;
3. Data e montimeve për instalimet e reja apo ekzistuese;
4. Koha e nevojshme për të futur teknikën më të mirë të mundshme;
5. Konsumi dhe natyra e lëndëve (përfshirë ujin) të përdorura në proces dhe efikasitetin e saj të energjisë
6. Nevoja për të parandaluar aksidentet dhe për të minimizuar pasojat e tyre për mjedisin
7. Nevoja për të parandaluar apo zvogëluar në minimum ndikimin e përgjithshëm të emetimeve në mjedis dhe rreziqet e për të.

Koncepti i teknikave më të mira të disponueshme nuk i drejtohet këshillimit të ndonjë teknike ose teknologjie të veçante, por marrjes parasysh të karakteristikave teknike të impianteve në fjalë, pozitën e saj gjeografike dhe kushtet lokale mjedisore.

9. Alternativën në lidhje më zgjedhjen e vendit të instalimit dhe teknologjinë e përdorur

Zona në fjalë është një zonë e cila sa vjen dhe zhvillohet më shumë. Për këtë arsye edhe fitimet ekonomike arrijnë targetin që kompania i ka vendosur vetes. Teknologjia është bashkëkohore dhe cilësia e shërbimit të ofruar nga Milenium i Ri është e lartë, duke rritur kështu dhe fluksin e punës.

10. Masat për parandalimin dhe rikuperimin e mbetjeve

Mbetjet e gjeneruara nga ky aktivitet janë kryesisht kartona dhe letra, për të cilat subjekti ka marrë këto masa:

1. Grumbullimi i mbetjeve nga kompania e certifikuar “ECO EMPIRE”
2. Transportimi i mbetjeve nga kontraktori i autorizuar

11. Masat për përdorimin eficient të energjisë

1. Auditimi vjetor, nga auditues në procese për evidentimin e përdorimit eficient të energjisë
2. Kualidim i vazhduar i aparaturave dhe makinerive.
3. Vlerësimi nga menaxheri i energjisë për gjendjen e impiantit dhe vlerësimin të pjesëve më të reja.
4. Vendosja apo zëvendësimi i pajisjeve jo më vonë se 2 vjet pas përfundimeve të dala nga Audituesi i Energjisë.

12. Monitorimi i planifikuar i shkarkimeve nga instalimet

Qëllimet e monitorimit mjedisor

Monitorimi për parametrin që na intereson bëhet nëpërmjet matjeve të përsëritura, që merren me një frekuencë të mjaftueshme, për të bërë të mundur vlerësimin e gjëndjes së mjedisit dhe ndryshimeve të tij në kohë.

Objektivat e Monitorimit:

- Të krahasojë cilësinë dhe gjëndjen e mjedisit para fillimit të aktivitetit me atë gjatë funksionimit të instalimeve;
- Të monitorojë emetimet (nëse ka) në të gjitha fazat e zhvillimeve të projektit në përputhje me normat dhe standartet ligjore të Shqipërisë dhe BE;

- Të përcaktojë nëse ndryshimet e mundshme mjedisore janë si rezultat i zhvillimeve të aktiviteteve që kryhen në rajonin ku ndodhet objekti ku janë instaluar linja e prodhimit dhe nëse ka lidhje dhe impakte kumulative me aktivitetin e propozuar;
- Për të përcaktuar efektivitetin e masave përmirësuese të zbatuara nga aktorët zhvillues të aktivitetit në rajon;
- Për të përcaktuar impakte afatgjate (nëse ka);
- Për të përcaktuar zgjatjen e kthimit në normalitet të cilësisë së mjedisit në rajon, në rastet kur vlerësohet se ka ndikime dhe impakte në të;
- Të krijojë një arkivë të cilësisë së mjedisit, një bazë të dhënash që do të mund të përdoret në të ardhmen.

13. Mbrojtja nga zjarri

Subjekti “Albamachinery” për ushtrimin e këtij aktiviteti ka marrë të gjitha masat e duhura në bazë të kushteve të parandalimit dhe mbrojtjes kundra zjarrit (PMKZ) për një funksionim normal dhe pa avari të pajisjeve të ndryshme në tërësi.

Pajisjet e mbrojtjes kundra zjarrit për këtë objekt janë të një rëndësie të veçantë, dhe janë të domosdoshme si një pikë themelore e funksionimit të tij. Subjekti është i pajisur me një akt teknik të PMNZSH ku janë parashikuar të gjitha masat që duhen të ndërmeren në raste të jashtëzakonshme, të parandalimit të zjarrit dhe menaxhimit të situatës së rrezikut të zjarrit në raste të veçanta. Në zbatimin e gërmës b, të Nenit 34 të Ligjit Nr.8796 datë 05.04.2001 “Për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimin”, Shoqëria ka marrë masat e nevojshme për mbrojtjen në raste rreziku rënie zjarri. Për mbrojtjen nga Zjarri në subjekt janë marrë masat e mëposhtme:

- Ka fikse zjarri me shkumë dhe pluhur;
- Ka rregullore të brendshme të PMNZSH-së;
- Personeli është i instruktuar me rregullat e PMNZSH-së;
- Automjeti Zjarrfikës afrohet nga të tre anët e objektit;
- Janë vendosur bombola zjarrëfikëse në ambjentet e punës;
- Në mënyrë periodike bëhet kontrolli i pajisjeve dhe i mjeteve të MNZ si dhe bëhet kolaudimi i tyre në mënyrë që të parandalohen rreziqet e mundshme;
- Janë vendosur tabela për mbrojtjen nga zjarri, si dhe për përdorimin e zjarrshuarsve në rast aksidente nga zjarri në pikën e karburantit;
- Për tu mbrojtur nga ndonjë zjarr i mundshëm që mund të bjerë janë ruajtur largësite mbrojtëse ndaj zjarrit duke ruajtur largësinë e godinës dhe objekteve për rreth;
- Janë lënë distancat e përcaktuara për rrugë kalim të automjeteve, zjarrfiksave.

Ky subjekt ushtron prej vitesh aktivitetin konform të gjitha ligjeve dhe dispozitive ligjore që kanë të bëjnë me ushtrimin e këtyre aktiviteteve. Gjatë kësaj periudhe ky subjekt ka zbatuar me korrektësi të gjitha dispozitat ligjore, kushtet teknike të punës, duke krijuar edhe një mjedis bashkëkohor për këtë lloj aktiviteti.

ADMINISTRATORE

SILVANA LUKA



